POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 Përplaset për vdekje kërcënbsori, po kalonte rrugën në aksin Maliq-Lozhan kur u aksidentua nga makina
2 FOTO nga ekzekutimi i Mondi Mëhallës në Elbasan
3 Ministrja Ibrahimaj: Në 2 dërgata nga pensionistët u tërhoqën mbi 42 mijë bonuse
4 'Motra joe eshtë pagjar'... pas komenteve negative për Beatrix, vëllai i saj, Albani merr vendimin që pritej
5 Jennifer Lopez mahnit me pamjen e saj në premierën e filmit të ri! Mungon Ben Affleck

Kronikë

Vlorë/ Qarkullonte i armatosur me makinë teksa ishte në arrest shtëpiak, pranga 22-vjeçarit

Një i ri ka rënë në prangat e policisë së Vlorës për armëmbajtje pa leje. Në pranga ka rënë edhe një 36-vjeçar, pasagjer.

22-vjeçari shoqërohet në Komisariat

Redaksia
2 Dhjetor, 13:42 | **Përditesimi: 2 Dhjetor, 13:50**

Share

Vlorë - Një 22-vjeçar ka rënë në prangat e policisë së Vlorës për armëmbajtje pa leje. I riu i cili ishte në arrest shtëpiak u ndalua në në lagjen "Pavarësia", teksa lëvizte i armatosur me automjetin e tij tip 'Benz'.

Në pranga ka rënë edhe një 36-vjeçar, pasagjer në makinën e të riut. Ky i fundit akuzohet për moskallëzim krimi.

Arma e zjarrit tip "Zastava", u sekuestrua si provë materiale.

LEXO EDHE:
Vlorë/ Reshjet e shiut, rrëzohet pema në Radhimë, bllokon një kah të rrugës

Njoftimi i policisë:

Në vijim të punës intensive për goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje dhe ndalimin e shtetasve që shmangin detyrimet ndaj masave të sigurisë të vendosura nga Gjykata, Seksioni për Mbështetjen Operacionale të Hetimit në DVP Vlorë, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Vlorë, në bazë të informacioneve të siguruara, organizoi dhe finalizoi operacionin policor të koduar "Befasia", në kuadër të të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit:

Sh. Z., 22 vjeç, banues në Selenicë, për veprat penale "Armëmbajtja pa leje" dhe "Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit".

M. D., 36 vjeç, banues në Selenicë, për veprën penale "Moskallëzim i krimit".

Shtetasi Sh. Z., i cili ndodhej nën masën e sigurisë "Arrest në shtëpi" për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", u kap në lagjen "Pavarësia", Vlorë, duke drejtuar automjetin tip "Mercedes Benz", ku pasagjer ndodhej edhe shtetasi M. D.

Gjatë kontrollit të shtetasit Sh. Z., shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan një armë zjarri pistoletë të markës "Zastava".

Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Vlore | armembajtje pa leje

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
25 Nëntor, 12:21
Si po iu duken protestat e përjavshme të PD-së para Kryeministrisë?
Të duhura | Të dështuara | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

VIDEOLAJM/ Ishte duke ecur në Lungomare, qentë endacakë sulmojnë një person në Vlorë
1 Dhjetor, 11:37

Vrapojmë për Pavarësinë, pamjet nga maratona që përmbylli festimet e Pavarësisë në Vlorë (VIDEO)
1 Dhjetor, 08:32

Vrapojmë për Pavarësinë/ 'Half Marathon' në Vlorë, 400 pjesëmarrës nga vende të ndryshme të botës
Armand Xhelili
30 Nëntor, 09:33

Vlorë/ Shpërthim me tritol në banesën e nënës së Gentjan Zotos, i dënuar për atentatin ndaj Inez Hajrullës! Flet 63-vjeçarja: S'kam konflikte (VIDEO)
Armand Xhelili
30 Nëntor, 07:25

Sarandë/ Qëlloi me armë dy të rinjtë para katër muajve, shkrumbohet lokali i Ramadan Zotos në Ksamil
29 Nëntor, 10:58

Vlora përkujton Ditën e Çlirimit, homazhe dhe mesazhe mirënjohjeje për Dëshmorët! Marrin pjesë përfaqësues vendor, deputetë e veteranë
29 Nëntor, 10:45

Flamuj kuq e zi, spektakël dronësh e fishekzjarrësh, Vlora mbyll festimet e 28 nëntorit me koncert, qytetarët mbushin bulevardin e qytetit
Armand Xhelili
28 Nëntor, 20:37

Opozita kremton e vetme festën e Flamurit në Vlorë, Berisha e Meta urojnë nga rrjetet sociale
28 Nëntor, 14:17

VIDEO/ Flamur Noka 'ngel' në histori, gafa për Ditën e Pavarësisë: Skëndërbeu ngriti flamurin në Vlorë...
28 Nëntor, 12:27

Mbahet në Sarandë ceremonia për 113-vjetorin e pavarësisë, mungojnë përfaqësuesit e PD! Kurora me lulet vendoset nga ish-kryetarja e degës (VIDEO)
28 Nëntor, 11:21

'Shqipëri moj shkëmb e gurë', qytetari si Ismail Qemali përshëndet shqiptarët me polifoni (VIDEO)
28 Nëntor, 10:48

Shqiptarët e Kosovës në Vlorë për Festën e Flamurit: 28 nëntori datë historike (VIDEO)
28 Nëntor, 10:38

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje